



PËRDITËSIM

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen *Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj*, Paneli i Apelit ka caktuar një seancë apeli më 1 dhe 2 dhjetor 2022. Gjykatësit vënë në dukje se, bazuar në Rregullore, vendimi mbi apelin kundër aktgjyqimit mund të merret tërësisht mbi bazën e parashtrimeve me shkrim. Sidoqoftë, ata e gjykojnë të nevojshme seancën për shkak të rrethanave konkrete të kësaj çështjeje, mes të cilave gjatësia dhe kompleksiteti i aktgjyqimit. Të gjitha parashtrimet me shkrim të Mbrojtjes dhe Prokurorisë në lidhje me apelin, që janë publike, gjenden në faqen e internetit të DHSK-së.

Në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, më 20 tetor Zyra Administrative dorëzoi raportin e nëntë mbi pjesëmarrjen e viktimave. Në raport, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave rekomandon që 11 nga 19 parashtruesit e kërkesave të pranohen si viktima në proces. Sipas Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave, krimet që ata pretendojnë se kanë pësuar përkohë me vendet dhe kohët e përmendura në Aktakuzë.

Viktimat flasin gjuhën shqipe dhe/ose serbe dhe banojnë në shtete të ndryshme. Ndër ta përfshihen viktimat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Viktimat e drejtpërdrejta tregojnë se kanë pësuar dëm për shkak të ndalimit të paligjshëm, trajtimit mizor dhe/ose torturës në një nga vendet e ndalimit që përmenden në Aktakuzën e konfirmuar. Viktimat e tërthorta pretendojnë se kanë pësuar dëm si rezultat i përndjekjes, ndalimit të paligjshëm, trajtimit mizor, torturës, zhdukjes me forcë dhe/ose vrasjes së paligjshme të një anëtarit të familjes.

Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave vlerësoi se të gjitha viktimat kanë pësuar krime të ngjashme me ato që pretendohet se janë kryer nga të njëjtët kryes në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*. Për rrjedhojë, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave rekomandoi që 11 viktimat e tjera të përfshihen në grupin ekzistues prej 32 viktimash pjesëmarrëse në këtë çështje dhe të përfaqësohen nga i njëjti mbrojtës viktimash.

Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave konstatoi më tej se, ashtu si në rastin e grupit ekzistues të viktimave pjesëmarrëse, të 11 parashtruesit e kërkesave duhet të konsiderohen veçanërisht të cenueshëm pasi vuajnë ende nga trauma dhe shprehin frikë dhe shqetësim për sigurinë e tyre dhe të familjeve të tyre, nëse identiteti i tyre bëhet i njohur. Për rrjedhojë, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave e çmon të nevojshme që identitetet e tyre të mbahen konfidenciale.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të vendosë në lidhje me kërkesat e viktimave si dhe mbi rekomandimet për mbajtjen konfidenciale të identiteteve të tyre.





Raporti i nëntë i Zyrës Administrative mbi pjesëmarrjen e viktimave gjendet në faqen e internetit të DHSK-së.

Siç u njoftua javën e shkuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka caktuar konferencën e radhës mbi ecurinë e kësaj çështje gjyqësore për të premtën e ardhshme, më 4 nëntor 2022, në orën 13:30. Ndër pikat që do të diskutohen, sikurse u bënë me dije në urdhrin për caktimin e datës së konferencës, përfshihen procesi i nxjerrjes së materialeve, listat e dëshmitarëve, si dhe ecuria hetimeve të Mbrojtjes.

Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake bëri me dije se do të pyesë Mbrojtjen dhe Prokurorinë nëse parashikojnë të hasin ndonjë vështirësi për kalimin e çështjes te trupi gjykues brenda fundit të këtij viti.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

